

RiTuR – Rinia për Turizmin në Roskovec

Projekti RiTuR

1. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Bashkia Rrokskovec disponon mundësi dhe asete për të zhvilluar ekonomie vendore, por nuk ka kapacitetet e mjaftueshme për t'u orientuar saktë drejt modeleve të qëndrueshme. Zhvendosja e interesit në turizmin e fermave apo agroturizmin si nga investitorët ashtu edhe nga vizitorët është e pranishme në thuajse të gjitha rajonet me karakter agrar zhvillimi duke premtuar rritje ekonomike të komuniteteve vendase, punësim dhe vetëpunësim në rradhet e të rinjëve dhe grave.

Synimi kryesor i Projektit është nxitja e rritjes ekonomike dhe punësimit në territorin e Bashkisë Rrokskovec nëpërmjet prezantimit të modeleve të zhvillimit të qëndrueshëm të mbështetura në asetet dhe burimet kryesore natyrore e kulturore dhe të udhëhequr nga parimi gjithëpërfshirjes së komunitetit, të rinjëve dhe grave në vecanti.

Me një kohezgjatje prej 8 muajsh ky projekt siguron shërbime mjaft efikase lidhur me menaxhimin e aseteve të territorit dhe vënien e tyre në shërbime zhvillimit ekonomik. Mbi të gjitha aktivitetet dhe veprimtaritë e propozuara për komunitetin janë gjithëpërfshirëse dhe tregojnë vëmendje të vecante ndaj të rinjëve dhe grave.

1. OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

Objekti kryesor i këtij propozimi është të nxirret rritjen ekonomike dhe punësimit në territorin e Bashkisë Rrokskovec nëpërmjet prezantimit të modeleve të zhvillimit të qëndrueshëm të mbështetura në asetet dhe burimet kryesore natyrore e kulturore dhe të udhëhequr nga

parimi

gjithëpërfshirjes së komunitetit, të rinjve dhe grave në vecanti.

Objektivi 1: Evidentimi i aseteve natyrore, historike dhe kulturore në Bashkinë e Rrokskovec dhe

vlerësimi i nivelit të terheqjes së tyre për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në këtë territor dhe

bashkëpunim dhe me përfshirjen e të gjithë paleve të interesit, veçanërisht të të rinjve dhe

grave;

Objektivi 2: Ndërgjegjësimi i grupeve të interesit mbi rëndësinë e përfshirjes së komunitetit në

zhvillimin e turizmit sipas modeleve të balancuara duke i meshuar grave dhe të rinjve ;

Objektivi 3: Përmirësimi i ofertës turistike nëpërmjet zhvillimit dhe promovimit të aseteve të

territorit dhe sipas praktikave tematike të aplikuara në vend;

1. **AKTIVITETET**

1. Identifikim i aseteve mbi të cilat bazohet oferta turistike e territorit të Rrokskovec;
2. Organizimi i një punëtorie me të rinjtë dhe grupet e interesit të Rrokskovec për ndërgjegjësimin lidhur me asetet dhe potencialin e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm;
3. Hartimi i një circuiti tematik në territor mbi të cilin mund të zhvillohen një game itinerarësh turistike;
4. Hartimi i një itinerari tematik me fokus promovimin e mjedisit, bio-habitatet, traditat dhe monumentet natyrore;
5. Organizimi i një punëtorie informuese dhe edukuese mbi agroturizmin si formë hibride sipërmarrjeje dhe marketingun dixhital për të rinjtë, gratë, dhe banorët e rajonit.
6. Prodhimi i materialeve të shkruara dhe ilustruese në funksion të rubrikës së dedikuar në

faqen zyrtare te bashkise si edhe pasurimi i mediave sociale me informacion.
7. Aktivitet permbylles i shoqeruar me nje tur familjarizues.



